

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)

Tremujori IV, 2014

Tiranë, më 04 Mars 2015: Në tremujorin e katërt 2014, indeksi i kushtimit në ndërtim (për banesa) arriti 102,3 % kundrejt tremujorit të parë 2011 (Tremujori i parë 2011=100).


Në tremujorin e katërt 2014 ndryshimi vjetor i indeksit të kushtimit në ndërtim (për banesa) është 0,1 %. Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2013, rritja më e madhe vërehet te grupi "Shpenzime për paga" me 1,6 % duke u ndjekur nga grupi "Shpenzime materiale" me 0,9 %. Brenda këtij grupi, rritja më e madhe vërehet në nëngrupet "Materiale ndërtimi" dhe "Materiale hidro-sanitare" me 1,0 % secila.

Në tremujorin e katërt të vitit 2014 krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2013, ulja më e madhe vjetore vërehet në grupin "Shpenzime makinerie" me 1,3 %.

Në tremujorin e katërt 2014 ndryshimi tremujor i indeksit është 0,2 %. Indeksi i çmimeve të grupit "Shpenzime materiale" është rritur me 0,3 % krahasuar me tremujorin e tretë 2014. Brenda këtij grupi rritjen më të madhe e kanë nëngrupet "Materiale hidro-sanitare" dhe "Materiale elektrike dhe komunikimi" respektivisht me 0,6 % dhe 0,3 %. Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2013, indeksi i grupit "Shpenzime për paga" u rrit me 0.2 %.

Indekset e grupeve "Shpenzime transporti" dhe "Shpenzime makinerie" u ulën me 0,1 % secili, krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Fig. 1 Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) sipas tremujorëve



Tab. 1 Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)

Tremujori i parë 2011=100

%

Kodi	Grupet	Peshat	IV-11	I-12	II-12	III-12	IV-12	I-13	II-13	III-13	IV-13	I-14	II-14	III-14	IV-14
	Totali (1+2+3+4+5+6)	100,0	100,5	100,3	100,7	101,1	101,0	101,5	101,7	101,6	102,2	101,7	102,0	102,1	102,3
1	Shpenzime materiale (a+b+c)	55,2	101,6	99,8	100,6	101,1	99,9	100,1	100,3	101,2	100,7	99,8	100,8	101,3	101,6
	a. Materiale ndërtimi	42,3	101,7	99,9	100,8	101,6	99,7	99,6	100,4	101,6	100,8	99,9	101,1	101,6	101,8
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	6,7	101,2	99,3	99,1	99,3	98,7	101,6	100,7	100,1	102,0	99,7	100,1	101,4	101,7
	c. Materiale hidro-sanitare	6,2	100,9	99,9	100,8	100,1	103,1	102,0	98,9	99,1	99,2	99,5	99,5	99,6	100,2
2	Shpenzime për paga	24,6	101,5	100,8	100,6	101,2	99,8	99,9	101,7	102,6	102,4	103,5	103,9	103,8	104,0
3	Shpenzime makinerie	8,3	100,1	100,9	101,9	103,9	102,9	102,9	105,2	104,6	104,4	102,1	102,9	103,1	103,0
4	Shpenzime transporti	5,3	100,2	100,5	101,7	102,4	102,7	102,4	103,7	102,8	102,6	102,8	103,1	103,4	103,3
5	Shpenzime për energji	2,1	100,0	100,0	100,0	100,0	100,3	100,3	100,3	100,3	100,3	100,3	100,3	100,3	100,3
6	Kosto të tjera	4,5	98,7	101,1	100,9	100,3	101,2	103,7	103,1	101,7	102,1	105,6	104,8	103,6	103,9

Tab. 2 . Ndryshimet tremujore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)

Kodi	Grupet	%												
		IV-11	I-12	II-12	III-12	IV-12	I-13	II-13	III-13	IV-13	I-14	II-14	III-14	IV-14
	Totali (1+2+3+4+5+6)	0,3	-0,2	0,4	0,4	-0,1	0,5	0,2	-0,1	0,6	-0,5	0,3	0,1	0,2
1	Shpenzime materiale (a+b+c)	1,1	-1,7	0,8	0,5	-1,2	0,1	0,2	0,9	-0,5	-0,9	1,0	0,5	0,3
	a. Materiale ndërtimi	1,3	-1,8	0,9	0,8	-1,9	-0,1	0,8	1,2	-0,8	-0,9	1,2	0,5	0,2
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	0,1	-1,8	-0,2	0,2	-0,6	3,0	-0,9	-0,6	1,9	-2,3	0,4	1,3	0,3
	c. Materiale hidro-sanitare	0,4	-0,8	0,9	-0,7	3,0	-1,1	-3,0	0,2	0,1	0,3	0,1	0,1	0,6
2	Shpenzime për paga	-1,1	-0,7	-0,2	0,6	-1,3	0,0	1,9	0,9	-0,2	1,1	0,4	-0,1	0,2
3	Shpenzime makinerie	0,2	0,8	1,0	2,0	-1,0	0,0	2,2	-0,5	-0,2	-2,2	0,8	0,1	-0,1
4	Shpenzime transporti	0,8	0,3	1,2	0,7	0,2	-0,3	1,3	-0,8	-0,2	0,2	0,2	0,3	-0,1
5	Shpenzime për energji	0,0	0,0	0,0	0,0	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
6	Kosto të tjera	1,1	2,4	-0,2	-0,6	0,9	2,5	-0,5	-1,4	0,4	3,4	-0,8	-1,2	0,3

Tab. 3. Ndryshimet vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)

Kodi	Grupet	%												
		IV-11/IV-10	I-12/I-11	II-12/II-11	III-12/III-11	IV-12/IV-11	I-13/I-12	II-13/II-12	III-13/III-12	IV-13/IV-12	I-14/I-13	II-14/II-13	III-14/III-13	IV-14/IV-13
	Totali (1+2+3+4+5+6)	0,7	0,3	0,9	0,9	0,5	1,2	1,0	0,5	1,2	0,2	0,2	0,5	0,1
1	Shpenzime materiale (a+b+c)	2,0	-0,2	0,3	0,6	-1,6	0,3	-0,3	0,1	0,8	-0,3	0,5	0,1	0,9
	a.Materiale ndërtimi	2,1	-0,1	0,4	1,2	-2,0	-0,3	-0,4	0,0	1,1	0,3	0,7	-0,1	1,0
	b.Materiale elektrike dhe komunikimi	1,7	-0,7	-0,6	-1,7	-2,5	2,3	1,6	0,8	3,4	-1,8	-0,6	1,3	-0,3
	c.Materiale hidro-sanitare	1,2	-0,1	0,8	-0,2	2,2	2,1	-1,9	-1,0	-3,8	-2,4	0,6	0,5	1,0
2	Shpenzime për paga	1,5	0,8	0,3	-1,4	-1,6	-0,9	1,1	1,4	2,6	3,6	2,1	1,1	1,6
3	Shpenzime makinerie	0,1	0,9	1,9	4,0	2,8	2,0	3,2	0,7	1,5	-0,8	-2,1	-1,5	-1,3
4	Shpenzime transporti	0,3	0,5	2,9	3,0	2,4	1,9	2,0	0,4	0,0	0,4	-0,6	0,5	0,6
5	Shpenzime për energji		0,0	0,0	0,0	0,3	0,3	0,3	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
6	Kosto të tjera		1,1	1,9	2,8	2,5	2,5	2,2	1,4	0,9	1,9	1,6	1,8	1,8

Metodologjia

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) (IKN) mat ecurinë e çmimeve të materialeve të ndërtimit, të fuqisë punëtore dhe të shpenzimeve të tjera kapitale që përdoren në ndërtimin e një banese tip (8 – 10 kate). IKN është një tregues i rëndësishëm ekonomik për sektorin e ndërtimit. Indeksi përdoret si deflator për llogaritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe Indekseve të ndryshme të volumit, përdoret nga Institucionet Qeveritare, Banka Qendrore e Shqipërisë, Organizata të tjerë joqeveritare, Banka Botërore, FMN etj. IKN duke filluar nga tremujori i parë 2011 llogaritet me shportën e re të materialeve. Peshat e këtyre materialeve janë llogaritur duke u bazuar në preventivat e shpenzimeve për ndërtimin e një banese shumëkatëshe marrë nga firmat e ndërtimi., Tremujori i parë i vitit 2011 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (tremujori i parë 2011=100). Shporta e re përbëhet nga 73 zëra nga të cilat 68 janë materiale ndërtimi. Çmimet për materialet e ndërtimit mbledhen nga 126 distributorë dhe shitës me shumicë të materialeve të ndërtimit. Ndërsa, të dhënat për shpenzimet për pagat, makineritë dhe transportin merren nga 50 ndërmarrje të mëdha ndërtimi të përqëndruara kryesisht në rrethin e Tiranës. Zgjedhja e ndërmarrjeve është bërë në bazë të volumit të ndërtimit që ato realizojnë gjatë një periudhe një vjeçare. Shpenzimet janë klasifikuar në përputhje me klasifikimin që përdor EUROSTAT për Indeksin e Kushtimit në Ndërtim, në gjashtë grupe kryesore si më poshtë:

- Shpenzime për materiale
- Shpenzime për paga
- Shpenzime për makineri
- Shpenzime transporti
- Shpenzime për energji
- Shpenzime të tjera

Për llogaritjen e Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) përdoret formula e Laspeyres:

$$I_{0t}^L = \frac{\sum_{i=1}^n \left(\frac{P_t^i}{P_0^i} \times w_0^i \right)}{\sum_{i=1}^n w_0^i} \times 100$$

Ku:

I_{ot} = Indeksi i periudhës t krahasuar me periudhën bazë 0

P_t^i = Çmimi për njësi i artikullit i në periudhën t (peridha korente)

P_0^i = Çmimi për njësi i artikullit i në periudhën 0 (periudha bazë)

w_0^i = Pesha e artikullit i në periudhën bazë

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit korent me të njëjtin tremujor të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit korent me tremujorin e mëparshëm.